

V E N D I M

Nr.591, datë 8.9.1998

PËR RRIJTJEN E ÇMIMEVE TË LIBRAVE SHKOLLORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të librave shkollorë të arsimit 8-vjeçar rriten 40 për qind dhe ato të arsimit të mesëm rriten 50 për qind, mesatarisht kundrejt çmimeve të shitjes së tyre me pakicë që janë në fuqi, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.68, datë 30.1.1995 “Për rritjen e çmimeve të librave shkollorë të arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm”.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të llogarisë çmimet e reja të këtyre librave dhe t'i shpallë ato për zbatim, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjithë librat shkollorë të arsimit parauniversitar që janë në qarkullim dhe që vazhdojnë të shtypen.

3. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme, për sasitë që janë në gjendje pranë subjekteve shtetërore përkatëse të shitjes me pakicë dhe të shtypura deri më 31.5.1998, të derdhen detyrimisht në Buxhetin e Shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës që, në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit lokal, të ndjekë dhe të marrë masa të nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemin e diferencave të çmimeve dhe derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit, gradualisht me shitjen e librave shkollorë gjendje me çmimet e reja.

5. Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së librave shkollorë të arsimit parauniversitar dhe çmimeve përkatëse me pakicë, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës përkatëse të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të nxjerrë, brenda muajit shtator 1998, udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Nano

Fatos